GUIDË E DISA SHTIGJEVE PËRGJATË KORRIDORIT EKOLOGJIK

P O L I S - V A L A M A R Ë - R U N G A J Ë - M O R A V Ë - G R A M O Z

Një libërth i krijuar nga guidat lokale

EcoAlbania

PONT | PRESPA OHRID NATURE TRUST

KY RAPORT ËSHTË HARTUAR NË KUADËR TË PROJEKTIT **“IMPROVE SUSTAINABILITY OF SOUTH-EASTERN CCAs IN ALBANIA - ISCCA”** ZBATUAR NGA **ECOALBANIA** ME FINANCIM TË **PRESPA OHRID NATURE TRUST (PONT)**. MBËSHTETJA E PONT-IT PËR PËRGATITJEN E KËTIJ BOTIMI NUK PËRBËN NJË MIRATIM TË PËRMBAJTJES QË PASQYRON VETËM PIKËPAMJET E AUTORËVE DHE PONT NUK MUND TË JETË PËRGJEGJËS PËR ÇDO PËRDORIM TË INFORMACIONIT QË PËRMBAN.

Raporti përgatitur nga: Gani Bego
Ilir Mema
Lytfi Alliu

Fotografitë: Gani Bego
Ilir Mema
Lytfi Alliu

HYRJE

Korridori ekologjik “Polis-Valamarë-Rungajë-Moravë-Gramoz” ndodhet në juglindje të Shqipërisë dhe përfaqëson një zonë të largët malore që prek pjesërisht territorin e Bashkive Librazhd, Përrenjas, Pogradec, Gramsh, Maliq dhe Skrapar. Ky korridor shtrihet midis gjashtë zonave të mbrojtura: Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë, Parku Natyror Stravaj-Sopot, Peizazhi i Mbrojtur Liqeni i Pogradecit, Peizazhi i Mbrojtur Guri i Nikës, Parku Natyror Mali i Tomorrit dhe Parku Natyror Dardhë-Xhyrë.

Korridori ekologjik “Polis-Valamarë-Rungajë-Moravë-Gramoz” luan një rol të rëndësishëm në krijimin e popullatave të qëndrueshme të gjitarëve, duke lidhur malet e Pindit në Greqi, me sistemin malor qendror të Shqipërisë. Vargmali Valamarë-Polis është vecanërisht i rëndësishëm, pasi përfaqëson zonën e dytë të konfirmuar për riprodhimin e Rrëqebullit të Ballkanit në Shqipëri, ku kamerat kurth kanë fotografuar një familje prej tre individësh. Në vitin 2020, prania dhe riprodhimi i tre mishngrënësve të mëdhenj (Ariu i Murrmë, Ujku, dhe Rrëqebulli i Ballkanit) u konfirmuan në ekosistemin Polis-Gur i Zi-Valamarë.

Pavarësisht vlerave natyrore, korridori përballet me presione gjithnjë e më të mëdha nga fragmentarizimi i habitatit si pasojë e prerjeve, zjarreve, urbanizimit, dhe përdorimit apo menaxhimit jo të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Këto sfida shpesh lidhen me kapacitetet e kufizuara financiare, teknike, dhe njerëzore; strukturat jo gjithmonë efektive të planifikimit dhe menaxhimit; mungesën e të dhënave dhe studimeve mbi vlerat natyrore; si edhe zbatimin e dobët të ligjit në fushën e ruajtjes së natyrës dhe standardeve mjedisore.

SHTEGU LLANGË - SHPELLA E AKULLIT

I lehtë

3 km

273 m

1 orë

Shtegu nis nga fshati Llangë, një nga vendbanimet më të vjetra të njësisë administrative të Steblevës. Ky fshat ka rëndësi historike dhe kulturore për zonën, duke reflektuar traditat dhe mënyrën e jetesës së komunitetit malor. Shtegu Llangë - Shpella e Akullit përfaqëson një ndërthurje të natyrës, trashëgimisë kulturore dhe mundësive rekreative.

Rruga kalon përmes pyjeve të dendur, duke ofruar hijen dhe freskinë e natyrës. Pas kësaj pjese, shtegu hapet në hapësira kullosore, të rrethuara nga pyje, duke krijuar një kontrast të qartë mes relievit të mbuluar me pemë dhe hapësirave të lira për ecje dhe pushim. Ky kombinim e bën rrugën të larmishme dhe të këndshme për ecje, si për turistët e rinj, ashtu edhe për vizitorët me përvojë më pak të avancuar në terren malor.

Shpella e Akullit, destinacioni final i shtegut, është fenomen natyror i rrallë. Akulli brenda saj ruhet dhe gjatë muajve më të ngrohtë, për shkak të kushteve të vecanta mikroklimatike. Ky aspekt e bën shpellën jo vetëm një atraksion turistik, por edhe një vend me interes gjeologjik dhe klimatologjik, ku mund të studiohen proceset natyrore të ruajtjes së akullit në terrene të larta malore.

SHTEGU LLANGË - SHPELLA E AKULLIT

PIKAT KRYESORE

Ky itinerar është i shkurtër dhe i lehtë, duke mundësuar përjetimin e peizazheve alpine dhe një fenomeni natyror unik.

ITINERARI

Atraksioni kryesor i këtij itinerari është Shpella e Akullit, që përfaqëson dhe destinacionin final të shtegut.

SHTEGU STEBLEVË - LIQENI I DRAGANIT - FAQET E LËMUEME

I moderuar

6.6 km

603 m

3 orë

Ky itinerar nis nga fshati Steblevë, një qendër malore që po njeh zhvillim të vazhdueshëm turistik falë përmirësimit të infrastrukturës rrugore dhe rritjes së vizitorëve të interesuar në turizmin natyror dhe të qëndrueshëm. Ky zhvillim ka krijuar mundësi për integrimin e komunitetit lokal në aktivitete turistike dhe promovimin e vlerave kulturore të zonës.

Rruga kalon përmes pyjeve alpine, duke ofruar një peizazh të pasur me bimësi. Përvec elementëve natyrorë, itinerari përfshin dhe aspekte kulturore dhe sociale. Pranë Liqenit të Draganit, një nga ndalesat kryesore të shtegut, ndodhet një stan tradicional, ku vizitorët mund të provojnë dhe njohin prodhimet bio dhe mënyrën e jetesës së barinjve vendas. Në brendësi të parkut, rreth një kilometër larg shtegut, gjenden stane të tjera që ende ruajnë traditën e barinjve të zonës. Kjo ndërthurje e natyrës me kulturën tradicionale e bën shtegun një hapësirë të vecantë për studim dhe përjetim.



Arritja tek Liqeni i Draganit përbën një nga ndalesat kryesore të shtegut. Ky liqen ka tipare mocalore dhe ndodhet pranë Shkëmbit të Draganit, një formacion shkëmbor me potencial për aktivitete ngjitjeje, duke i shtuar dimensionin sportiv dhe rekreativ shtegut.

Pika përfundimtare, Faqet e Lëmueme, përbën një formacion gjeomorfologjik të vecantë, me sipërfaqe shkëmbore të rrafshta dhe të lëmuara, si pasojë e proceseve natyrore. Nga ky vend, vizitorët mund të përftojnë një panoramë të gjerë të Parkut Shebenik, ndërsa në horizont dallohen malet e Dibrës.

SHTEGU RRAJCË BARDHAJ - LIQENET E RRAJCËS

I moderuar

11 km

753 m

5 orë

Ky shteg nis nga fshati Rrajcë Bardhë dhe përfundon në Liqenet e Rrajcës, duke ofruar një përvojë unike natyrore dhe kulturore. Pjesa më e madhe e rrugës ndjek rrugë makine, e përshtatshme për turistët, dhe që garanton siguri gjatë ecjes. Shtegu kalon përmes kullotave alpine dhe pyjeve të dendura te ahut, duke ofruar një pamje mahnitëse dhe mundësi për vëzhgimin e florës dhe faunës lokale.



Liqenet e Rrajcës janë liqene akullnajore që ndodhen në një lartësi prej 2000 m mbi nivelin e detit, të formuar nga aktiviteti glaciar dhe që përfaqësojnë shembuj të shkëlqyer të formacioneve natyrore alpine. Në këtë zonë buron lumi i Bushtricës, një nga lumenjtë më të pastër dhe ekologjikisht të rëndësishëm në Shqipëri, por në të cilin tashmë po ndërtohen tre HEC-e. Rrajca është gjithashtu një rajon i rëndësishëm për specie të florës dhe faunës, përfshirë Rrëqebullin e Ballkanit, simbol i faunës së Parkut Kombëtar të Shebenikut.

Për realizimin e shtegut, rekomandohet që vizitorët të jenë të pajisur me ujë mjaftueshëm, ushqim dhe veshje të përshtatshme për ecje malore. Gjatë rrugës ndodhen dy burime ujore. Shegu është më i përshtatshëm për të ecur nga muaji maj deri në fund të shtatorit, për shkak të kushteve atmosferike dhe aksesueshmërisë. Ky itinerar ofron një mundësi të shkëlqyer për të eksploruar bukuritë natyrore dhe pasuritë ekologjike të Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë, duke ofruar një përvojë autentike dhe duke kontribuar në promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë natyrore të Shqipërisë.

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E SHTIGJEVE

Për të përmirësuar përvojën e vizitorëve dhe për të siguruar një menaxhim të qëndrueshëm të shtigjeve, rekomandohet të ndërmerren disa veprime në pesë fusha kryesore.



Rifreskimi i shenjave me bojë sipas standardeve dhe vendosja e tabelave orientuese dhe paralajmëruese në pikat kryesore të shtegut, janë hapa të rëndësishëm për të siguruar udhëzimin e vizitorëve.

Sugjerohet krijimi i vendpushimeve me stola dhe hije. Po ashtu, vendosja e koshave për mbeturinat dhe pastrimi i shtigjeve janë të domosdoshme. Shënimi i pikave panoramike do të lejojë vizitorët të vëzhgojnë peizazhet dhe të realizojnë fotografi përgjatë itinerarit.



Vendosja e tabelave edukuese mbi natyrën, historinë dhe kulturën e zonës, do të ofronte një kontekst edukativ për vizitorët. Zgjerimi i përdorimit të kodeve QR, mund të ofrojnë një përmbajtje digjitale shtesë, si harta interaktive, audio guidë dhe materiale të tjera edukative.

Tabela paralajmëruese në segmentet e vështira, numrat e emergjencës dhe koordinatat e dukshme të GPS janë elementë kryesorë për të garantuar sigurinë e vizitorëve. Mirëmbajtja e rregullt dhe monitorimi i shtigjeve janë gjithashtu të domosdoshme.

Përfshirja e banorëve lokalë në mirëmbajtjen e shtigjeve dhe ofrimin e shërbimeve turistike mund të rrisë përvojën e vizitorëve, por edhe përfshirjen e komunitetit lokal në ruajtjen e natyrës. Promovimi i aktiviteteve të ndryshme si hiking, biking dhe vëzhgimi i yjeve, si edhe krijimi i broshurave dhe aplikacioneve për turizëm natyror, do të bëjnë shtigjet më tërheqës dhe ndërveprues.



SHTEGU QAFË PLLOCË - GURI I KAMJES - OSNAT

Mesatar

14 km

560 m

5-6 orë

Shtegu nis nga vendi i quajtur Qafë Pllocë, në afërsi të rrugës së re Qafë Pllocë-Qukës, në një lartësi rreth 900 m mbi nivelin e detit. Gjatë pjesës së parë të rrugës, peizazhi dominohet nga pamja mbresëlënëse e Liqenit të Pogradecit, ndërsa terreni kalon përmes pyjeve natyrale të gështenjës në lartësitë 1100-1200 m. Më tej, rruga shtrihet nëpër livadhe alpine dhe pyje të dushkut dhe ahut, duke krijuar përzierje harmonike të peizazheve pyjore dhe livadheve të hapura. Zona karakterizohet nga sipërfaqe të kultivuara me vreshta, pemë arrore dhe livadhe të gjera, që pasqyrojnë aktivitetin bujqësor tradicional të banorëve lokalë.

Pika kryesore e shtegut është Monumenti i Natyrës “Guri i Kamjes”. Ky formacion gjeologjik unik ndodhet në1461 m mbi nivelin e detit dhe shërben si kufi ndarës midis krahinave të Gorës dhe Mokrës. Guri i Kamjes është një formacion ranor i formuar nga proceset natyrore të erozionit, erës dhe temperaturave, me përmasa mbresëlënëse: 100 m i gjatë, 80 m i gjerë dhe 70 m i lartë. I parë nga lart, ai të krijon përshtypjen e një anijeje që lundron mbi pyllin e blertë që e rrethon.

Përvec vlerave natyrore, ky monument ka rëndësi të vecantë historike, pasi më 28 korrik 1912 u lidh “Besa Gorare”, një ngjarje e rëndësishme patriotike, ku përfaqësues nga Gora, Mokra dhe Opari, të udhëhequr nga Kajo Babjeni dhe Ismail Dërdusha, shpallën mëvetësinë e krahinave të tyre, katër muaj para shpalljes së pavarësisë në Vlorë. Kjo datë ende festohet nga banorët e zonës, si një simbol krenarie dhe identiteti rajonal.

Pas ndalesës tek Guri i Kamjes, shtegu zbret drejt fshatit Osnat, një vendbanim karakteristik malor ku banorët merren kryesisht me blektori dhe në masë të vogël me bujqësi, për shkak të terrenit të pjerrët. Aktualisht, në fshat jetojnë rreth 18 familje, me një numër të përgjithshëm prej 70-80 banorësh. Shtëpitë tradicionale prej guri i japin fshatit një pamje autentike, ndërsa vitet e fundit vihet re një tendencë për përdorimin e llamarinave metalike në cati, si rezultat i përpjekjeve për modernizim dhe mirëmbajtje të banesave.

Në tërësi, shtegu Qafë Pllocë-Guri i Kamjes-Osnat përfaqëson një kombinim të jashtëzakonshëm të vlerave natyrore, historike dhe kulturore, duke ofruar një përvojë të plotë për vizitorët që kërkojnë të eksplorojnë trashëgiminë dhe peizazhet e pasura të zonës së Mokrës dhe Gorës.

SHTEGU DARDHAS - GURI I KAMJES - OSNAT

Mesatar

7 km

460 m

3-4 orë

Rruga nis nga fshati Dardhas, që është qendra e njësisë administrative me të njëjtin emër. Fshati ndodhet rreth 12 km nga qyteti i Pogradecit, ose afërsisht 20 minuta udhëtim me automjet. Dardhasi ka pasur një rëndësi të vecantë ekonomike para viteve '90, falë minierës së qymyrgurit, e cila ishte funksionale deri në fillim të asaj dekade. Pas mbylljes së minierës, pjesa më e madhe e popullsisë u orientua drejt bujqësisë, blektorisë ose emigracionit, të cilat mbeten dhe sot një burim i rëndësishëm të ardhurash për banorët.

Në fillim të itinerarit, vizitorët kalojnë pranë godinave të vjetra të ish-minierës, ku ndodheshin dikur zyrat, mencat dhe fjetoret e punëtorëve. Edhe pse sot këto godina janë të lëna në harresë, ato ruajnë vlera historike dhe arkitekturore, dhe me një investim të moderuar mund të rivitalizohen në funksion të turizmit lokal, si pika ndalese ose qendra informimi.

Më tej, shtegu vazhdon në drejtim të zonës së quajtur Dardhishtë, prej nga fshati ka marrë dhe emrin. Kjo zonë është e pasur me pemë të vjetra dardhash, që i japin peizazhit karakterin e tij të vecantë dhe dëshmojnë për traditat e zonës. Ndërsa ecja përparon, në horizont shfaqet madhështor, Guri i Kamjes, Monumenti Natyror që dominon panoramën e krahinës së Gorës.

Guri i Kamjes përbën destinacionin kryesor të shtegut, një formacion gjeologjik i rrallë, i njohur për përmasat dhe historinë e tij natyrore dhe kulturore. Nga ky këndvështrim, vizitorët mund të sodisin peizazhin e gjerë të zonës së Gorës. Pas qëndrimit në këtë pikë, shtegu zbret gradualisht drejt fshatit Osnat, i cili është i njohur për blektorinë tradicionale dhe mikpritjen karakteristike të komunitetit malor.

Në tërësi, shtegu Dardhas - Guri i Kamjes - Osnat përfaqëon një kombinim harmonik midis historisë industriale, trashëgimisë natyrore dhe jetës rurale, duke ofruar një përvojë të plotë për vizitorët që kërkojnë të njohin nga afër karakterin e zonës.

SHTEGU DARDHAS - GURI I KAMJES - DARDHAS

Shtegu Dardhas - Guri i Kamjes - Dardhas përfaqëson një itinerar rrethor që i mundëson vizitorëve një përvojë të plotë në natyrë, duke filluar dhe përfunduar në të njëjtin destinacion.

Pika kryesore e këtij shtegu është padyshim Monumenti i Natyrës “Guri i Kamjes”, një formacion gjeologjik mbresëlënës që ofron pamje panoramike dhe një përvojë unike për vizitorët. Falë formës rrethore të itinerarit, ky shteg është vecanërisht i përshtatshëm për vizitorët që duan të eksplorojnë natyrën, kulturën dhe biodiversitetin e zonës, pa pasur nevojë për transport shtesë për rikthim.

Mesatar

10 km

460 m

5 orë

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E SHTIGJEVE

Mungesa e infrastrukturës së përshtatshme mbetet një sfidë kryesore për zhvillimin e shtigjeve në përputhje me standardet e përcaktuara. Aktualisht, markimi dhe shënjimi me bojë në terren është i pjesshëm dhe kërkon rifreskim të plotë sipas udhëzimeve zyrtare. Po ashtu, pajisja e shtigjeve me tabela informuese dhe sinjalizuese është ende e kufizuar; ndonëse janë ndërmarrë disa iniciativa nga bizneset lokale, këto nuk përmbushin standardet e nevojshme për orientimin dhe sigurinë e vizitorëve.

Regjistrimi i shtigjeve në aplikacione të specializuara që përdoren nga turistët, gjithashtu është një nevojë e rëndësishme, me qëllim që itineraret të jenë lehtësisht të aksesueshëm. Krahas kësaj, rekomandohet hartëzimi dhe shpërndarja e hartave fizike dhe digjitale, të përditësuara dhe të përshtatshme për përdorim nga vizitorët vendas dhe të huaj.



Në shumë segmente vërehet se shtigjet janë të mbuluar nga bimësia, si pasojë e mos përdorimit të tyre, ndaj është i domosdoshëm pastrimi dhe hapja e tyre periodike. Një aspekt i rëndësishëm është promovimi i shtigjeve nëpërmjet agjencive kombëtare dhe ndërkombëtare të turizmit natyror, në mënyrë që ato të përfshihen në paketat turistike ekzistuese dhe të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

Së fundmi, për të përmirësuar përvojën e vizitorëve, rekomandohet ndërtimi i të paktën dy ballkoneve panoramike prej druri përgjatë itinerareve, një me pamje nga Liqeni i Pogradecit, dhe tjetri në afërsi të Gurit të Kamjes, ku ofrohet panoramë mbresëlënëse e gjithë krahinës së Gorës dhe majës së Valamarës në sfond.

SHTEGU GUR TOP - KROI I MUSHKËS

I vështirë

21 km

7-8 orë

Ky shteg ndjek një rrugë malore që lidh Gur Topin me Kroin e Mushkës, duke përshkuar një nga zonat më të paprekura të Polis-Valamarë-Rungajë-Moravë-Gramoz. Peizazhi i egër dhe natyra e virgjër e bëjnë këtë itinerar një udhëtim të vecantë për të njohur biodiversitetin dhe bukurinë e maleve shqiptare. Ky itinerar karakterizohet nga ngjitje dhe zbritje të pjerrëta dhe të thepisura, ndaj rekomandohet për grupe me eksperiencë, me veshjet dhe pajisjet e duhura për ngjitje në mal.

Rruga fillon nga Qafa e Rovjes dhe ndjek gjurmët e një rruge të vjetër pyjore, e përdorur dikur për transportin e druve të zjarrit. Gjatë ngjitjes kalohen pika si Guri i Gegës dhe Liqeni i Gur Topit, ku udhëtarët përgatiten për ngjitjen drejt Gur Topit, një nga pikat kryesore të itinerarit. Nga maja, panoramat janë mahnitëse, një pamje 360 gradë që përfshin liqene, vargmale dhe pyje. Sipas rrëfimeve lokale, ky mal e ka marrë emrin gjatë Luftës Italo-Greke, kur në këtë zonë transportoheshin me mushka topat e ushtrisë italiane drejt kufirit me greqinë.

Pas Gur Topit, rruga vazhdon përgjatë kufirit Pogradec-Gramsh, përmes një terreni të gjelbëruar ku mund të vëzhgohen thëllëzat dhe shpendë të tjerë. Pas një zbritjeje të pjerrët, itinerari vijon me ngjitjen drejt Majës së Valamarës, ku peizazhi dominohet nga pisha të zeza dhe bimësi barishtore e dendur. Në majë, vizitorët mund të sodisin liqenet akullnajore dhe një panoramë të gjerë të vargmaleve përreth.

Pas kësaj pike bëhet zbritja dhe ndalesa për pushim dhe kalimin e natës, me përgatitjen e zjarrit dhe hapjen e cadrave. Të nesërmen, rruga vazhdon përgjatë vargmalit deri në Kroin e Mushkës, në Liqenin e Zi, në kufi me Gramshin dhe Korcën, ku përfundon itinerari.

Në zonë gjenden dhe bujtina dhe struktura pritëse në Grabovë të Sipërme dhe rreth Liqenit të Zi, ku vizitorët mund të qëndrojnë gjatë sezonit veror. Aktualisht po zhvillohen investime për turizëm dimëror, edhe pse këto mbeten ende në fazë planifikimi.

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E SHTEGUT



Rruga nga Qafa e Rovjes deri në Kroin e Mushkës ndjek segmente të vjetra të cilat prej kohësh nuk janë mirëmbajtur dhe kanë humbur aksesin. Nevojitet përmirësimi i infrastrukturës së kalimit në këto pjesë.

Gjithashtu, mirëmbajtja e shtegut si edhe markimi e shënjimi janë të domosdoshme për ta bërë itinerarin më të lehtë për vizitorët.

Për shkak të terrenit të pjerrët dhe kushteve të vështira në disa segmente, vizitorët duhet të jenë të përgatitur dhe të respektojnë masat e sigurisë, vecanërisht zbritjet ekstreme. Megjithatë, kjo duhet të shoqërohet me tabelat dhe sinjalistikën përkatëse, në mënyrë që vizitorët të jenë të informuar për rreziqet e ndryshme përgjatë itinerarit.



Gjithashtu, rekomandohet vendosja e hapësirave të caktuara për kamping përgjatë shtegut, si dhe instalimi i koshave të mbeturinave për të ruajtur pastërtinë dhe për të përmirësuar përvojën e vizitorëve.

Skanoni për të eksploruar shtigjet: